



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.73/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë/Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në konfliktin administrativ, të paditësit ‘S...’ ShPK me seli në Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.B Avokat në Prishtinë, Rr. “...”, nr. ..., kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike - anulim vendimi, objekt kontesti - rivlerësim malli, vlerë kontesti – 1,941.08€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse K.B dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur A.H, me datë 12.10.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT kërkespadia e paditësit ‘S...’ ShPK me seli në Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.B Avokat në Prishtinë, dhe atë lidhur me deklaratën unike doganore R-18106 datë 26.09.2017, si e bazuar.
- II. ANULOHET PJESËRISHT vendim i Doganës së Kosovës nr. 01.3.2.2/803;831;715/2017 i datës 30.10.2010, vetëm sa i përket Deklaratës Unike Doganore R-18106/26.09.2017.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit ‘S...’ ShPK me seli në Fushë Kosovë, t’ia kthej shumën prej 1,410.47€ (njëmijë/e/katërqind/e/dhjetë/euro/e/katër dhjetë/e/shtatë/cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-18106/26.09.2017, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Mitrovicë, me kamatë ligjore prej 8% nga data e pagesës 26.09.2017, e deri në kthimin e plotë, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

IV. REFUZOHE T pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit 'S...' ShPK me seli në Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.B Avokat në Prishtinë, dhe atë lidhur me Deklaratën Unike Doganore R-21310 datë 06.11.2017, si e pa bazuar.

V. MBETET NË FUQI Aktvendimi nr. 01.3.2.2/803;831;715/2017 i datës 30.10.2010, i Doganës së Kosovës në Prishtinë lidhur me Deklaratën Unike Doganore R-21310/06.11.2017.

VI. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

ARSYETIM

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse:

Paditësi 'S...' ShPK me seli në Fushë Kosovë, përmes përfaqësuesit të autorizuar me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 16.12.2020, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë si të bazuar, të anulohet aktvendimi i Doganës së Kosovës në Prishtinë nr.01.3.2.2/803;831;715/2017 i 30.10.2010 si i pabazë, dhe të obligohet e paditura që të bëjë kthimin e mjeteve të paguara në emër të detyrimeve të importit mbi vlerën e transaksionit në shumë prej 1,941.08€ me kamatë ligjore në shkallë prej 8%, nga datat e pagesave e deri në kthimin e plotë. Përfaqësuesi i palës paditëse në padi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se e paditura edhe në rastin e rishqyrtimit të kësaj lënde nuk ka marrë për bazë vërejtjet dhe rekomandimet e gjykatës sipas aktgjykimeve A.nr.2135/17 të datës 16.10.2020 dhe A.nr.141/18 të datës 10.06.2020. Në këtë seancë e precizon kërkesëpadinë, duke kërkuar nga gjykata që të anulohet dispozitivin I dhe II të aktvendimit të atakuar, pasi që pjesa tjetër është aprovuar nga vet e paditura. Për shkak të rivlerësimit paditësi ka paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore mjetet në vlerë prej 1,410.47 € për DUD R-18106/26.09.2017, dhe mjetet në vlerë prej 530.61 € për DUD R-21310/06.11.2017, përkatësisht totalin prej 1,941.08 €, të cilat kërkon t'i kthehet paditësit së bashku me kamatën e grumbulluar në shkallë prej 8% nga datat e pagesave të detyrimeve doganore, e deri në kthimin e plotë. Kjo vlerë është përlllogaritur në bazë të DUD-ave të paraqitur nga paditësi dhe atyre të ndryshuar nga e paditura. Vlera e kërkesëpadisë nuk është

kontestuese nga e paditura, pasi që kjo vlerë është evidentuar në padi, ndërsa me përgjigjen në padi nuk ka pasur kontestim të saj. Tutje i sqarohet gjykatës se tek DUD-i kontestues R-21310/06.11.2017 fatura është e datës 01.11.2017 në të cilën është theksuar numri i konsumatorit: 198735 dhe numri i porosisë: 15614, në vlerë prej 4,140.00 €. Kjo faturë është paguar nga paditësi me anë të transaksionit bankar të datës 01.11.2017, në të cilin transaksion tek përshkrimi është evidentuar numri ku shihet se numri i fundit ndryshon nga fatura, si dhe është shënuar numri i porosisë i njëjtë me atë si në faturë. Prandaj, konsiderojmë se ndryshimi i një numri në përshkrim mund të jetë gabim teknik, sepse vlera e këtij transaksioni bankar është në përputhje të plotë me vlerën e faturës dhe është realizuar në datën e lëshimit të faturës. Tek DUD-i R-18106/26.09.2017 është bashkangjitur Pro Fatura e datës 15.09.2017 në të cilën është evidentuar numri i konsumatorit 198735 dhe numri i porosisë 156109 në vlerë prej 2,245.00 €, e cila është paguar përmes transaksionit bankar të datës 18.09.2017 në përshkrimin e të cilit janë vendosur dy numrat e theksuar në Pro Faturë dhe vlera e këtij transaksioni përputhet me vlerën e Pro Faturës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në padinë të datës 06.12.2021 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi është marrë në bazë të dispozitave ligjore që janë në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesja e palës së paditur në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se paditura e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësi si të pa bazuar, dhe i propozon gjykatës që të njëjtën ta refuzon në tërësi si të pa bazuar, dhe të lenë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm dhe të drejtë. Konsiderojmë se aktvendimi është marrë konform dispozitave ligjore në fuqi, dhe ajo në të cilën pretendon pala paditëse se është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron, për arsye se pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka mbështetur me asnjë provë të vetme. Po ashtu, nuk qëndrojnë pretendimet e palës paditëse se e paditura gjatë marrjes së vendimit nuk ka marrë për bazë rekomandimet e gjykatës në rivendosje, për arsye se e paditura në rastin konkret gjatë marrjes së aktvendimit ka marrë për bazë dhe ka shqyrtuar të gjitha

pretendimet e palës paditëse dhe rekomandimet e gjykatës, ku siç është cekur edhe në aktvendimin kontestues për Deklaratën Unike Doganore me numër 20450/25.10.2017 ka aprovuar kërkesën e palës dhe i ka kthyer mjetet, pasi që për këtë rast ka poseduar dokumentacion të mjaftueshëm dhe të harmonizuar për këtë mall. Ndërsa sa i përket Deklaratave Unike Doganore të cekura në aktvendim, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës është konstatuar se pala paditëse nuk ka bashkangjitur dokumentacion të mjaftueshëm për të dëshmuar vlerën e deklaruar se është vlerë reale, pasi që për këtë mall ka munguar Deklarata Eksportuese e lëshuar nga Autoritetet e shtetit Eksportues në të cilin duhet të jenë të cekura detajet e mallit duke përfshirë edhe çmimin e mallit. Po ashtu, ka munguar Kontrata e Shitblerjes e lidhur mes eksportuesit dhe importuesit në të cilën duhet të jenë të cekura përshkrimi i mallit, çmimi i mallit, kushtet e dërgesës etj. Në rastin konkret gjatë marrjes së aktvendimit për këto Deklarata Unike Doganore, bazuar në Udhëzimin Administrativ 11/2009, e paditua përmes telefonit ka kërkuar dokumentacion shtesë, e ka kërkuar Deklaratën Eksportuese nga Holanda si dhe Kontratën e Shitblerjes për importet nga Holanda, mirëpo i njëjti është përgjigjur se nuk i posedon. Andaj, mbi bazën e këtyre të dhënave në mënyrë të drejtë është vendosur kur është refuzuar kërkesa e palës paditëse dhe kur është vendosur që rivlerësimi i mallit të bëhet në bazë të dhënave të disponueshme si dhe zhdoganimeve të rregullta nëpër degë, të cilat zhdoganime janë të cekura në aktvendimin kontestues. Ndërsa lidhur me vlerën e kërkesëpadisë, e njëjta është e saktë me të dhënat e Doganës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor kryesor:

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 12.10.2022, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi 803;831;715/2017 i datës 30.10.2020, DUD-at kontestues me MV1 dhe MV6 R-21310/06.11.2017, R-18106/26.09.2017, Faturat numër 1/01.11.2017, Urdhërpagesat Ndërkombëtare të datës 01.11.2017, 18.09.2017, Deklarata EXA e datës 19.10.2017, CMR, Pro Fatura nr.156109/15.09.2017, Përgjigja në Padi e datës 06.12.2021, Proceset mbi Përcaktimin e Vlerës së Mallrave për DUD-at R-21310 dhe R-18106, DUD-at referues R-9023, R-13807, R-12457, R-16868, R-22753, R-7476, R-

19921, Ankesat e ushtruara në Doganën e Kosovës nr.831/05.12.2017, nr.715/20.10.2017, Aktvendimi nr.803;831/27.12.2017, nr.803;831/2017/14.10.2020.

Gjykata, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Faktet:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga DUD-at kontestues të Doganës së Kosovës, deklarimeve në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në senacën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuesë fakti se paditësi me datë 06.11.2017, ka paraqitur DUD-in R-21310 dhe me datë 26.09.2020 ka paraqitur DUD-in R-18106 për zhdoganim pranë zyrës së brendshme doganore Mitrovicë, me ç'rast të njejtit janë procesuar, duke u ri-vlerësuar bazuar në metoden e 6-të, të vlerësimit të mallrave. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, me datë 05.12.2017 dhe 20.10.2017, ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilat ankesa, Dogana e Kosovës me datë 27.12.2017, ka sjell Aktvendimin nr.803, 831 dhe me datë 31.10.2017 ka sjell aktvendimin nr.715, si akte administrative përfundimtare të nxjerra në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilët ka refuzuar ankesat e këtu paditësit, tutje lidhur me këto lëndë kjo Gjykatë duke vendosur sipas padisë së paditësit me Aktgjykimin A nr.141/18 të datës 10.06.2020 dhe Aktgjykimin A. nr.2135/17 datë 16.10.2020, i ka aprovuar paditë e paditësit, ka anuluar aktvendimet kontestuese dhe lëndën e ka kthyer në Rishqyrtim – rivendosje, ndërsa e paditura duke vepruar sipas këtyre Aktgjykimeve në Rishqyrtim – rivendosje ka sjell aktvendimin nr. 01.3.2.2/803;831;715/2017 të datës 30.10.2020, me të cilin prapë ka refuzuar ankesën e këtu paditësit lidhur me DUD-at R-21310/06.11.2017, dhe R-18106/26.09.2020 e ndaj të cilin aktvendim paditësi me padinë e datës 16.12.2020 ka iniciuar prapë këtë konflikt administrativ.

Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit kontestues nga Gjykata:

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, për rishqyrtimin e deklaratës unike doganore R-21310/06.11.2017 dhe R-18106/26.09.2020. E paditura ka vlerësuar se zyra e pranimit qëndëror ka vepruar drejtë kur e ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qellim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Dokumentacioni përcjellës i mallit është vlerësuar si i pamjaftueshëm për arsye se mungon deklarata eksportuese dhe kontrata e shitblerjes, dokumente këto që do të dëshmonin obligimet e njëres palë dhe tjetres, çmimin e mallit, kushtet e dërgesës ku në harmoni me dokumentet tjera do të dëshmonte se vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit, nga ana tjetër Dogana e Kosovës disponon me të dhëna që janë në dispozicion në Kosovë dhe që janë në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme të sesionit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, e cila vlerë është më e lartë se vlera të cilën e ka deklaruar subjekti në procedurë.

Vlerësimet faktike dhe juridike të Gjykatës, lidhur me piken I, II dhe III, të dispozitivit të këtij Aktgjykimi:

Gjykata konstaton se e paditura vendimin kontestues ndonëse e ka nxjerr në ri procedurë duke vepruar në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2135/17 të datës 16.10.2020 dhe A.nr.141/18 të datës 10.06.2020, ajo nuk i ka respektuar pikëpamjet juridike të Gjykatës, pra ka nxjerr vendim në kundërshtim me udhëzimet dhe vërejtjet e Gjykatës, duke anashkaluar kështu detyrimet ligjore nga neni 65 i LKA-së.

Gjykata vlerëson se e paditura sikurse në vendimin e parë refuzues me nr.715 të datës 31.10.2017, për rishqyrtimin e vendimit nr.R-18106/26.09.2017, të Zyrës së Brendshme

Doganore Mitrovicë ka dhënë arsyetim të njëjtë sa i përket bazës ligjore ku e paditura e ka mbështetur vendimin e kontestuar. Sipas të paditurës Dogana e Kosovës disponon me të dhëna nga Dosja e Vlerës dhe të dhënat e disponueshme që vlera e mallit është dukshëm më e lartë se vlera e deklaruar nga subjekti.

Për Gjykatën një konstatim i tillë është i pa qëndrueshëm dhe në kundërshtim edhe me udhëzimet e dhëna nga Gjykata kur rasti është kthyer në rivendosje. E paditura ka dështuar të veprojë sipas udhëzimit të dhënë me vendimin e Gjykatës me të cilin rasti ishte kthyer në rivendosje e ku e paditura ishte obliguar që në përputhje me autorizimet nga neni 82 paragrafi 1 të KDA-së, e obligon të paditurën që të deklarohet lidhur me faturën dhe transaksionin bankar të paditësit, për të konstatuar se fatura, transaksioni bankar dhe dokumentet përcjellëse pse nuk janë marr për bazë dhe nuk janë pranuar si valide.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-it nr.R-18106/26.09.2017 të Zyrës së Brendshme Doganore Mitrovicë dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 1,410.47€, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se paditura do të mund ta mbështetur një konstatim të këtillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit mbi çmimin neto të faturës të mallit, ku vlera e mallit të faturuar nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes transaksionit bankar të datës 18.09.2017 në Pro Credit Bank në emër të faturës së mallit lëndor kontestues nr. ... të datës 15.09.2017, e cila është në harmoni të plotë në kuptim të shumës dhe përshkrimit.

Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësim të mallit dhe caktim të bazës së re doganore për paditësin, fakti që e paditura disponon me të dhëna nga Dosja e Vlerës, në bazë të cilit vlera e mallit është dukshëm më e lartë se vlera e deklaruar nga subjekti, sepse me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK-së nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të marra nga Dosja e Vlerës, por aty përkundrazi shprehimisht përcaktohet se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjete tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*.

Sipas nenit 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është parashikuar që, dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Në interpretim të drejtë të dispozitave ligjore të cituara, Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur faturën e mallit lëndor nr. ... të datës 15.09.2017 e cila është paguar përmes transferit bankar në Procredit Bank të datës 18.09.2017, deklaratën eksportuese. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Arsyetimi i të paditurës i dhënë në vendimi e kontestuar se në shkresat e lëndës ka munguar kontrata e shitblerjes prandaj Dogana e Kosovës e ka të pamundur të pranoj vlerën e transaksionit të subjektit në procedurë, për Gjykatën nuk është i bazuar, sepse me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109 dhe as me dispozitat e UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, nuk parashihet që kontrata e shitblerjes është dokument i cili duhet bashkangjitur deklaratës doganore, për vendosje në qarkullim të lirë të mallit të importuar dhe për tu aplikuar metoda e parë e vlerësimit sipas nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, komfor nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Nisur nga kjo, gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b, të KDAK-së nr.03/L-109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, miratoj kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'i kthej shumën prej 1,410.47€, të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit të pa drejtë mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar përmes DUD-it me nr. R-18106/26.09.2017, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e pagesës 26.09.2017, e deri në kthimin e plotë të kësaj shume si dhe duke pasur parasysh mendimin Juridik për kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 datë 02.12.2020.

Gjykata konstaton se shuma e paguar më tepër nga paditësi në emër të detyrimeve doganore, si pasojë e rivlerësimit të mallit nga e paditura nuk u kontestua as nga përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës gjatë seancës së shqyrtimit kryesor dhe se kjo shumë u vërtetua edhe nga gjykata me rastin e krahasimit të vlerës së detyrimeve doganore në DUD-in e kontestuar, në versionin e paraqitur nga paditësi tek e paditura dhe atë të rivlerësuar, përkatësisht kalkulimi 2,675.48-1,265.01€, ku rezultojë vlera 1,410.47€, e cila paraqet shumën e detyrimeve doganore të paguar nga paditësi si rezultat i ri vlerësimit të mallit nga e paditura.

Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas kërkesëpadiës nga i autorizuari i paditësit gjatë seancë së shqyrtimit gjyqësor, duke pasur parasysh dispozitën e nenit 292 pika b) (i), të KDAK-së nr.03/L-109, ku parashihet “*Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme*” dhe dispozitat ligjore të nenit 170 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku thuhet se “*Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit*” dhe nenit 382 paragrafi 2 të këtij ligji ku thuhet se “*Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”.

Vlerësimet faktike dhe juridike të Gjykatës, lidhur me piken IV dhe V, të dispozitivit të këtij Aktgjykimi:

Nga arsyetimi i vendimit kontestues Gjykata konstaton se e paditura e ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim me deklaratat unike doganore R-21310/06.11.2017, nuk është çmim real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë. Zyra e pranimit qëndëror ka vepruar drejtë kur gjatë rivlerësimit të mallit është bazuar në metodën e 6- të vlerësimit, neni 35, i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme, pasi që vlera e deklaruar e mallit është vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDA-së.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ Gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për deklaratën unike doganore R-21310/06.11.2017, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që Gjykatës t’ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtet e transaksionit

e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Përkundrajt pretendimeve të paditësit në padi i cili thekson se mallin lëndor e kanë përcjell të gjitha dokumentet e nevojshme të cilat kërkohen për vendosje të mallit në qarkullim të lirë, Gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë konflikt administrativ është i pamjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paraqit vlerën reale të mallit lëndor.

Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmojë vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar Gjykatës provat materiale tjera si faturën e mallit lëndor nr. ... të datës 01.11.2017, e njëjta nuk ka arrit të dëshmojë vlerën reale të paguar për mallin lëndor, prandaj edhe Gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues, pasi që fakti vendimtar për tu dëshmuar se është paguar vlera e deklaruar e mallit lëndor, e që në këtë rast është transaksioni bankar apo çfarëdo pagese tjetër për mallin e importuar. Paditësi në këtë rast ka prezantuar urdhërpagesën e datës 01.11.2017, mirëpo nga përshkrimin në këtë urdhërpagesë kuptojmë se kjo pagesë nuk i përket faturës së mallit lëndor kontestues, pasi që në përshkrim është shënuar ‘pagese e faturës 198736’, ndërsa fatura e mallit lëndor kontestues është me numër

Si fakte vendimtare që kanë ndikuar në rivlerësimin e mallit lëndor ka qenë mungesa e dokumentacionit përcjellës të harmonizuar, në këtë rast e transaksionit bankar andaj edhe e paditura Dogana e Kosovës është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit neni 35, i Kodit Doganor dhe Akcizave respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme. Gjykata vlerëson se në rastet kur nuk kemi prova të mjaftueshme apo se ato janë jo të harmonizuara nga paditësi, për ta mbështetur vlerën e transaksionit në procedurë doganore, atëherë edhe rivlerësimi i mallit lëndor sipas të dhënave të disponueshme – zhdoganimeve të mëherëshme bazuar në nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, nga Dogana është e pranuar dhe e mbështetur në KDA-nr, Kodi 03/L-109, prandaj Gjykata konstaton se është aplikuar drejt dispozita ligjore, neni 35 i KDA-së, kur është rivlerësuar malli lëndor në deklaratën unike doganore R-21310/06.11.2017.

Gjykata konsideron se në këtë rast paditësi nuk ka arrit të dëshmoj vlerën e transaksionit të paguar për mallin lëndor, R-21310/06.11.2017, kështu që nuk mund të pranohen pretendimet se paditësi ka prezantuar të gjitha dokumentet e nevojshme për tu pranuar vlera mallit lëndor konform nenit 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. Gjykata konstaton se paditësi me asnjë dokument nga eksportuesi nuk ka konfirmuar çmimin e mallit lëndor, apo dëshmi valide e të harmonizuar se është bërë pagesa e mallit doganor.

Nga provat e administruara Gjykata nuk ka gjetur fakte të bazuara që argumentojnë se paditësi i ka paguar eksportuesit vlerën reale të mallit lëndor sipas faturave përcjellëse të mallit, Gjykata nuk e pranoi si valide urdhërpagesën bankare të datës 01.11.2017, pasi që të njëjtat nuk është paguar në emër të faturës së mallit lëndor kontestues, ndaj Gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka konfirmuar rivlerësimin e mallit lëndor për deklaratën unike doganore R-21310/06.11.2017, nga zyra doganore duke aplikuar metodën e 6 të vlerësimit, neni 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave përkatësisht të dhënave të disponueshme-zhdoganimeve të mëherëshme.

Nga kjo gjendje Gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, për arsye se nga pretendimet e fakteve të paraqitura në procedurën e konfliktit administrativ, nuk janë paraqitur provat e nevojshme që do të dëshmonin vlerën e transaksionit të mallit lëndor.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, ndërsa në nenin 34 par.1 të KDAK-së parashihet që “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur*

vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij". Tutje neni 35, par 1. kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 33 ose 34, do të përcaktohet në bazën e të dhënave të disponueshme në Kosovë, duke përdorë metoda të arsyeshme në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme: si, Marrëveshjen për implementimin e Nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë e vitit 1994;. Nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë e vitit 1994; dhe Dispozitave të këtij kreu. Nga këto dispozita ligjore dhe duke pasur parasysh edhe nenin 123 par.1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave, ku parashihet që “*Dokumentet në vijim duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë: a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti*”.

Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222 se: “*Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit*”.

Neni 7 Parag 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.*” Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Vendimi që secila palë t’i bart shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.C, 81.I par.2 pika 2.1 dhe 2.3 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, si dhe nenit 43, par 1 dhe 2, e 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë/Departamenti Fiskal

KF.nr.73/22 datë 12.10.2022

Bashkëpunëtori Profesional

Visar Gashi

Gj y q t a r i,

Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate